



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

---

## E K S T R A K T

**i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, mbajtur më 02.12.2022, duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fatime Demolli-Mustafa, kryesuese, Ramadan Salihu, Mehreme Llumnica, Gyltene Retkoceri, Jeton Canhasi dhe Armend Ademi.

**Munguan:** Ermira Shabani.

**Në mbledhje ishin të pranishme edhe:** Kryetari i Kryeqytetit Përparim Rama, Adelina Sahiti, drjtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Premtime Preniqi, koordinatorë për të drejtat e njeriut, Habib Qorri përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Albulena Ahmeti nga Drejtoria e Arsimit, Sebahate Beqiri, përfaqësuese e shoqatës "Down Sindrome Kosova", Igballe Grajçevci, Agim Bulliqi qytetar me aftësi të kufizuar nga lagjja "Kodra e Trimave", dhe Besa Preniqi - interprete.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli, kryesuese e komitetit me këtë:

## REND TË DITËS:

- "Qasja dhe fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar në Komunën e Prishtinës", në vigjilje të 3 dhjetorit - Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.**

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese, i përshëndeti të pranishmit, dhe ceku se Dita ndërkombëtare e PAK-ra, është vendosur 3 dhjetori me Rezolutën 47/3, në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Qëllimi i kësaj dite është promovimi i të drejtave, mirëqenies si dhe rritja e ndërgjegjësimit lidhur me situatën e PAK-ra, në të gjitha sferat e shoqërisë dhe aspekte të zhvillimit, jetës politike, sociale, ekonomike e kulturore.



Këta persona përgjithësisht kanë më shumë probleme shëndetësore, mundësi më të pakta ekonomike, edukim dhe arritje akademike më të ulët. Kjo ndodh më shumë për shkak të barrierave me të cilat ata përballen në jetën e tyre të përditshme, sesa si rrjedhojë e aftësisë së kufizuar.

Sipas raportit të organizatës botërore të shëndetësisë, 15% e popullsisë të botës ose 1 miliardë njerëz jetojnë me paaftësi. Po ashtu ceku se edhe në vendin tonë çdo vit shënohet kjo ditë e cila në mënyrë të veçantë i bashkon PAK-ra, në veprimtari të ndryshme, në nivele lokale e kombëtare që kanë për qëllim sensibilizimin e institucioneve shtetërore dhe të shoqërisë për përmirësimin dhe realizimin në praktikë të drejtave të atyre që u jep statusi i PAK-ra.

Po ashtu ceku Komiteti Konsultativ i PAK-ra, i Komunës së Prishtinës si mekanizëm institucional komunal shënon këtë ditë duke u solidarizuar kështu me të drejtat e PAK-ra, si dhe për të mësuar për mundësitë e përmirësimit dhe avancimin të këtyre personave në shoqëri që sa i përket nivelit lokal të qeverisjes.

Qëllimi i shënimit të kësaj date është publiku të njihet me atë se çka është paaftësia dhe si PAK-ra, mund të jetojnë dhe të punojnë në mënyrë të pavarur dhe t'i kontribuojnë bashkësisë së vet. Një nga sfidat është që pajisjet ndihmëse dhe trajnimi për përdorimin e tyre janë të shtrenjta dhe shumë PAK-ra, në komunën tonë nuk mund t'i sigurojnë, edhe kur i kanë këto pajisje ata përballen ende me pengesa të shumta të lëvizjes, si mungesë të hapësirave të sigurta dhe të çastshme në qytet të cilat mund të shfrytëzohen, mungesë të trotuareve, si dhe mungesa e fushave taktile të cilat lehtësojnë shfrytëzimin e pajisjeve ndihmëse.

Është me rëndësi që institucionet komunale të caktojnë mjete dhe të miratojnë programe të cilat përfshijnë sigurimin pa pagesë të pajisjeve ndihmëse për PAK-ra, si dhe trajnime për lëvizje të lehtësishme.

Sfidë tjetër dhe më kryesorja është gjithë përfshirja e PAK-ra, që nënkupton arsimimin dhe punësimin e tyre.

Komiteti fton të gjitha institucionet komunale t'i plotësojnë obligimet e veta nga Konventa e Kombeve të Bashkuara, mbi të drejtat e PAK-ra, nga legjislacioni ynë përkatës e në veçanti nga plani i veprimit për PAK-ra, sikurse që fton dhe inkurajon komunitetin e aftësisë së kufizuar në Komunën e Prishtinës të bashkëpunojë me komitetin konsultativ për PAK-ra.

**Përparim Rama**, kryetar i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje, duke thënë se dita ndërkombëtare e PAK -ra, po shënohet nesër me 3 dhjetor sipas një tradite të filluar qysh në vitin 1992 e cila ka qenë edhe Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Shumë organizata ndërkombëtare i bashkohen organizatës së OKB-së, në shënimin e kësaj dite meqë ajo synon të promovojë mirëkuptimin për çështjet e aftësisë së kufizuara dhe me mobilizuar mbështetjen për dinjitetin të drejtat dhe mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara në çdo nivel.

Po ashtu informoi për disa veprime konkrete të Kryeqytetit të përqendruara në gjithë përfshirjen për lehtësimin për PAK-ra, në jetën sociale, ku ceku se Kryeqyteti ka ofruar mbështetje financiare prej afro 300 mijë euro, për organizata të ndryshme të shoqërisë civile që merren drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve sociale të kategorive të ndryshme të PAK-ra.

Po ashtu Kryeqyteti ofron edhe dhjetëra organizata dhe mundësi për të shfrytëzua hapësirat e ndryshme pa asnjë kosto financiare, në mënyrë që ato të mund të zhvillojnë aktivitetet të ndryshme shumë të nevojshme sociale për persona me aftësi të kufizuara. Po ashtu për herë të



parë në Kryeqytet dhe mendoj që edhe në Kosovë i kemi vendosë shenjëzimet dhe godinat në institucionet e kryeqytetit për personat e verbër, është ky një instalim i cili është financuar prej organizatave jo qeveritare.

Po ashtu i kemi ulë edhe dy sportele pra në godinat tona poshtë që mundën me ofruar shërbime me të mira për përdoruesit e karrocave, pra të kenë mundësi për një qasje më të mirë në të njëjtën kohë kemi sigurua një printer me kode Brail i cili në mënyrë që çdo vendim me rëndësi të mund të shtypim edhe për nevojat e personave të verbër, si dhe kemi ofrua edhe pajisjet ndihmëse qysh në pjesën e parë të vitit. Në shkollat e Prishtinës i kemi tre psikologë të verbër të cilët nuk është që janë në punë vetëm për shkak se janë të verbër, por mundën me kryer shërbime të mira profesionale për Kryeqytetin.

Po do t'i ndërtojmë tri shkolla të reja të cilat bazë i kanë të gjitha aspektet e PAK-ra, pra edhe me aspekte fizike të lëvizjes, po ashtu edhe të ndjeshmërisë edhe të pamjes, pra i kanë pikat kyçe.

**Adelina Salihu**, tha si Komunë e Prishtinës si Drejtori e Mirëqenies Sociale, në vazhdimësi e kemi dëshmuar e po vazhdojmë ta dëshmojmë se jemi për një shoqëri gjithëpërfshirëse, ku me veprime dhe hapa konkret që kemi ndërmarrë, ne kemi ngritur fondin për organizatat e shoqërisë civile të cilat ofrojnë shërbime direkt për PAK-ra. Po ashtu ne po ofrojmë vërtetë shuma të cilat janë të dedikuara për kategoritë e veçanta, për rastet sociale, e që janë PAK-ra, do t'ia dalim që t'iu ndihmojmë.

Është shumë e rëndësishme që në këtë panel janë akterë të shumtë, janë njerëz të cilët avokojnë dhe janë të zëshëm kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave të PAK-ra.

Po ashtu ceku se kanë bërë ndryshime brenda objekteve të komunës, kemi shtuar stafin në Qendrën për Punë Sociale, çka ka qenë për 20 vitet e harruar si institucion, si ndër institucionet më të rëndësishme për ofrimin e shërbimeve sociale. Kemi bërë shumë punë, por kemi edhe shumë punë para vetes, e do të bëhen edhe shumë më të mëdha në vitet që pasojnë.

**Sebahate Beqiri**, përfaqësuese në shoqatën "Down Sindrome Kosova", i përshëndeti të pranishmit dhe përgëzoi dhe falënderoj Kryetarin dhe Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, për fondin që është ndarë për shërbimet sociale. Është një fond rreth 300 mijë euro, mendoj që ky fond sado pak do të kontribuojë në përmirësimin e shërbimeve sociale, apo ta them në trajtimin e dinjitetshëm të qytetarëve me aftësi të kufizuara të Komunës së Prishtinës.

Gjithashtu përgëzoi iniciativën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, për kthimin e grupit që do të monitorojë projektet të cilat kanë përfituar nga Komuna e Prishtinës. Se kemi pasur shumë herë përfitues të projekteve apo të fondeve të cilat destinohen për PAK-ra, përfitojnë shoqatat të cilat nuk janë të profilizuara apo ta them nuk kanë kapacitete të mjaftueshme apo nuk kanë njerëz profesional për të ofruar shërbime për PAK-ra.

Të organizohen edhe punëtori në grupet e interesit, që organizatat që përfaqësojnë grupe të ndryshme të PAK- ra.

Po ashtu kërkoi nga Kryetar të bisedon me Drejtorinë e Shëndetësisë, tash ne e dimë që është planifikuar buxheti, mirëpo të planifikohen ndarje të fondeve edhe për shërbime shëndetësore. Ne po mundohemi brenda programit që ne e kemi, programit të intervenimit dhe edukimit të hershëm, ofrojmë këto shërbime, janë shërbime terapeutike, mbështetëse dhe shërbime sociale, mirëpo një pjesë duhet të kalojë edhe te Drejtoria e Shëndetësisë, shërbimi i logopedisë, fizioterapisë, që janë shërbime të cilat i takojnë fushës sociale.



Po ashtu kërkoi nga Kryetari të fillojnë bashkërisht të ndërmarim iniciativë për ndryshimin e udhëzimit administrativ sepse stafi i cili punon në ekip vlerësues duhet të jetë staf permanent, jo ta ketë punë sekondare punën në ekip vlerësues.

Po ashtu tha se ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm se si do të menaxhohet kjo qendër, le të sigurohemi që kjo qendër do të ofrojë shërbim për fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit që kanë nevojë.

**Mehreme Llumnica**, i përshëndeti të pranishmit e cila tha se është kënaqësi që të shohim mangësitë, të arriturat, iniciativat, e rëndësishme është që të gjitha këto iniciativa të vlerësohen, të monitorohen sa ka cilësi dhe si do të shkojë puna, me dokumentet që janë dalë nga vetë PAK-ra dhe përfaqësuesit edhe organizatat edhe institucionet që merren me shërbimet për qytetarët me aftësi të kufizuara, siç është plani veprimtari pastaj siç është komiteti që është dikaster si urë lidhëse përmes OJQ-ve edhe institucioneve apo dikastereve komplet të Komunës së Prishtinës. Po ashtu i parashtroj pyetje Kryetarit, se në grupin e këshilltarëve në Komunën e Prishtinës a ka ndonjë ekspert, a ka ndonjë qytetarë me aftësi të kufizuara në grupin e këshilltarëve komunal që drejtpërdrejt merreni ju me idetë e tyre, a keni edhe përfaqësues direkt ose personel, ekspert që do të jetë edhe vet PAK-ra në grupin e këshilltarëve tuaj, do të kish qenë shumë i mirëseardhur një këshilltarë në grupin tuaj.

**Përparim Rama**, kryetar dha sqarime të nevojshme për pyetjen e parashtuar nga znj. Llumnica.

**Mehreme Llumnica**, po ashtu parashtroi pyetjen edhe për drejtoren e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, që në dy dikasteret kyçe që ofrojnë shërbime shumë të rëndësishme për qytetarët e Komunës së Prishtinës, është rritur stafi, dua ta di se në mesin e atij stafi a e keni bashkëpunëtor një PAK-ra, që ka me qenë profesionist në fushën e shërbimeve që ofrojnë këto dy dikastere.

Po ashtu e parashtroj edhe një pyetje që u përmend për 300 mijë euro për objektet që janë dhënë në shfrytëzim pa pagesë etj. a do të jetë një linjë buxhetore e caktuar, një fond i caktuar i përhershëm për përkrahjen e aktiviteteve e sidomos përfaqësuesve të OJQ-ve, që merren me aftësitë e kufizuara.

**Adelina Sahiti**, drejtore dha sqarime për pyetjet e parashtuara nga znj. Llumnica.

**Agim Bulliqi**, tha se është PAK-ra, nga lagja "Kodra e Trimave" dhe nuk është i kënaqur aspak për arsye të "Xhamia e Llapit", nuk ka mbulesë për me prit autobusët në stacion ku ka 40 vite apo më shumë, as më parë asgjë s'kanë bërë, ju është dashur të bëni.

**Përparim Rama kryetar**, dha sqarime lidhur me pyetjen e z. Bulliqi.

**Armend Ademi**, përshëndetje për të gjithë, sidomos për kryetarin, për drejtoritë dhe për të gjithë pjesëmarrësit po ashtu ju jemi shumë falënderues dhe jemi shumë të kënaqur me aktivitetet që po arrijmë me i zhvilluar si shoqatë, gjithmonë duke iu referuar mbështetjes nga Komuna e Prishtinës dhe drejtoritë e komunës, po shpresojmë që kemi me pasur bashkëpunim të mëtutjeshëm si deri më tani për mirëqenien e shoqatës tonë.

Në takimin që e kemi pasur tash së fundi me nën kryetarin kemi biseduar si temë kryesore që me filluar me pas të vizualizuara lajmet, njoftimet e ndryshme që jep komuna.



**Sebahate Beqiri**, dha sqarime lidhur me pyetjet që i parashtrou Mehremja.

**Ramadan Salihu**, tha se të drejtat e PAK-ra, janë të drejta të arritura dhe ato nuk mund të mënjahen, ato mund të realizohen, sepse ato janë të sublimuara me Konventë Ndërkombëtare, me ligjet tona dhe me planet e veprimit. Ne i monitorojmë ato dhe gjejmë se ka zbatueshmëri pjesërisht, por duhet të rritet kjo zbatueshmëri. Një shenjë e mirë është punësimi i tre PAK-ra, siç e theksoi edhe vetë kryetari e që kemi dhe një informacion që, është bërë një procedurë e rekrutimit, vendimmarrjes që kanë caktuar asistent paraprakisht.

Shoqatat duhet të kenë kushte sepse ato nuk janë profitabile dhe s'mund të bëjnë vet kushte për vete, ashtu qysh është e nevojshme, kështu që përpos këtyre shoqatave që kanë specifikat e veta, siç janë Autizmi, Down Sindrome Kosova, shoqatat tjera do të llobojnë që ta kenë një ndërtesë të përbashkët, sepse edhe ligji është i përbashkët sepse edhe terminologjia gjithmonë përdoret e përbashkët, unike për të gjithë, ndaj edhe ndërtesat duhet të jenë.

**Albulena Ahmeti**, tha se për herë të parë në Komunën e Prishtinës këtë mandat janë punësuar 15 asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta, jo që më herët nuk ka pasur mundësi por s'është bërë asnjëherë punësimi. Ekipi i vlerësimit është e vërtetë që ka shumë punë, mirëpo në krahasim me vitet e kaluara kanë qenë 22, ekipi këtë periudhë do të thotë që i ka bërë 160 vlerësime të fëmijëve me nevoja të veçanta. Po ashtu në mënyrë vullnetare kemi filluar ta bëjmë edhe monitorimin e vlerësimeve të cilat po dëshirojmë me pa se sa po respektohen ato rekomandime që ne po i japim, 25 psikolog veçse janë punësuar, vendimi është marrë prej kryetarit për sigurimin e transportit për fëmijët me nevoja të veçanta.

**Adelina Sahiti**, drejtore dha sqarime të nevojshme.

**Vehbi Mujku**, tha se edhe me iu përshtat kritereve për ligjet kundër diskriminimeve edhe me gjet një formë sepse ligji kundër diskriminimit do të na lejojë në një pikë, ku mundemi të bëjmë përjashtim dhe mos me mbetur peng.

**Sebahate Beqiri** dha sqarime.

**Premtime Preniqi**, arsyeja e krejt komitetit që ka filluar e gjitha kjo iniciativë, ka qenë për shkak të një fëmije që e kemi pasur me Sindromën Down, ka qenë i lagjes "Matiçan", a është dashur me e dërgua fëmijën në "Gëzimi Ynë", faktikisht kjo ka qenë si nxitje e komitetit për ta filluar këtë proces.

**Sebahate Beqiri** dha sqarime.

**Fatime Demolli-Mutafa**, kryesuese the se atëherë ka qenë iniciativë e Komitetit, sepse Komuna e Prishtinës, e ka paguar një transport, por e ka paguar vetëm për nxënësit në shkolla, e nuk e ka paguar për fëmijët në institucione parashkollore. Me kërkesë të Komitetit, Drejtorja e Arsimit më saktësisht zyrtarja Albulena Ahmeti kërkesën e Komitetit e ka drejtuar të Kryetari dhe e ka miratuar një vendim të tillë.



Sikur çdo shërbim tjetër që duhet të ketë kritere, unë mendoj që edhe ky shërbim i kompensimit të transportit duhet të ketë kritere, Komuna e Prishtinës nëse nuk gaboj e ka një udhëzim administrativ, i cili kërkon vërtetim të bashkësisë lokale, kërkon vërtetim të fëmijut në cilin institucion ndodhet, kërkon certifikatë të lindjes, diagnozë, një raport të vlerësimit pedagogjik sepse kompetencat e ekipit pedagogjike janë ato nëse fëmijës i takon transporti, nëse i takon asistenti, mësuesi mbështetës dhe të gjitha shërbimet e tjera.

Besoj që zyrtarja na informon më gjerësisht sepse është vendim që e ka miratuar drejtorja e Arsimit.

**Albulena Ahmeti**, dha sqarime shtesë lidhur me këtë Vendim.

**Mehreme Llumnica**, bëri pyetje një prind nëse nuk e ka një informacion për organizatën, a dilni ndonjëherë në vizita, identifikim.

**Sebahate Beqiri**, dha sqarime për pyetjen e parashtruar Mehremja.

**Mejreme Llumnica**, shprehi shqetësimin se nuk është kjo dilemë vetëm për Sindromën down, p.sh. ata me dëmtime intelektuale e kryejnë edukimin në qendrën burimore 8 vjeçare, shkojnë edhe deri në të mesmen dhe po mbesin askund pastaj, as nuk marrin diplomë.

**Sebahate Beqiri**, dha sqarime lidhur me këto çështje.

**Habib Qorri**, dha sqarime lidhur me planet të cilat ndikojnë drejtpërdrejt te PAK-ra duke fillua prej çasjes në infrastrukturë, në sport, parkingje, ashensorë, etj. Qysh në fillim të vitit ne kemi pas kërkesë prej të gjitha shoqatave për qasje në parkingjet publike tani që menaxhohen prej ndërmarrjes publike "Prishtina Parking", dhe që prej atëherë ne kemi marrë si zotim që do ta bëjmë draftimin e kësaj rregullore në mënyrë që të kemi bazën ligjore jemi në fazën finale të kësaj rregullore ku janë përfshirë edhe nenet të cilat i lirojnë prej pagesave.

Po ashtu ka qenë kërkesë edhe të draftimi i rregullores për transportin "Taxi", që përfshihen të secili operatorë privat kompani që të përfshihen edhe mjetet që plotësojnë kushtet për PAK- ar, dhe këtë e kemi të përfshirë po ashtu në rregullore, po ashtu projekteve që do të kenë ndërhyrje në infrastrukturë përmes planit të mobilitetit.

**Fatime Demolli-Mustafa**, kryesuese tha se kërkesë e komitetit kanë qenë edhe këto të dyja, madje janë në plan të veprimit dhe lirimi i parkingjeve për PAK-ra, dhe lirimi i taksive në këtë rast për personat, sigurimi. Ne si komitet ju falënderojmë jashtë mase drejtorinë e juaj që i ka potencuar këto kritere t'i vendosë në rregulloret e juaja.

**Ramadan Salihu**, tha se kërkoj nga ju ta shqyrtoni mundësinë që me një vendim të përkohshëm administrativ deri me implementimin e rregullores të bëhet një zgjidhje e mundshme për këtë çështje.

**Armend Ademi**, tha se në disa shkolla të qytetit ka fëmijë të shurdhër, mirëpo problem komunikimi nuk kanë as interpret as asistent dhe ai fëmijë nuk e di se si mbërrin të mësojë diçka



në klasë me fëmijët e tjerë. Sipas rregullave, ligjeve që i kemi lexuar, një fëmijë i shurdhër prej klasës së parë deri në klasën e pestë duhet të ketë asistent, prej klasës së gjashtë e tutje i lejohet interpretuesi.

Ju kisha lutë Drejtorisë së Arsimit, me ju përmbajt kësaj, do të kishte me qenë mirë me pas kontakt me ata prind me i informuar që fëmija duhet me pas dikë, për shkak që ne nuk po mundemi kushtimisht po them me urdhëruar asnjë prind, secili vendos për fëmijët e vet, ndoshta ndryshe e marrin informatën prej institucioneve që janë relevante për këtë temë.

Gjithashtu edhe për këtë programin për vlerësimin që i bëhet sidomos për fëmijët e shurdhër është e ndryshme për shkak që fëmija i shurdhër e ka komunikim gjuhën e shenjave. Ne si shoqatë jemi duke hulumtuar se si do të mund të arrijmë deri aty por që është akoma e vështirë me bërë një vlerësim të fëmija i shurdhër për shkak që ai përdor gjuhën e trupit, mimikat e fytyrës, por si zakonisht të gjithë e kemi këtë problemin e arsimit, edukimit po shpresoj që do të bëhet një zgjidhje për të gjithë.

I lus të gjithë për çfarëdo informatë sidomos për fëmijët e shurdhër të më drejtohen si shoqatë, çka kemi mundësi kemi me ofruar ndihmë.

**Fatime Demolli**, tha se meqenëse Armendi vjen nga shoqata e të shurdhërve dhe me ligj qenka kjo që nga klasa e parë deri në të pestën me pas asistent, kish qenë mirë me nda me ne se cili ligj e thotë sepse unë nuk kam hasë në këtë kriter, nen që e potencon.

Të gjithë jemi në dijeni që Komuna e Prishtinës, i ka punësuar asistentët, mirëpo këta asistent e kanë nivelin e pestë të cilin e ndjekin një vjeçar dhe për të ndjekur nivelin e pestë një vjeçar, studentët mësojnë për kategori të ndryshme të aftësisë së kufizuar, mirëpo nuk i dedikohen alfabetit Brailit, në këtë rast për personat e verbër, gjuhës së shenjave, ata kalojnë nëpër ligjërata por jo të jenë të profesionalizuar.

**Albulena Ahmeti**, dha sqarime të mjaftueshme lidhur me çështjet e cekura nga parafolësit.

**Fatime Demolli-Mustafa**, kryesuese sugjeroi që Armendi me i dërguar dy-tre emra sa nuk ka filluar ende procesi i mësimdhënies për nivelin e pestë, mundet të bëjë kërkesën në Ministrinë e Arsimit, dhe në Agjension, d.m.th janë dy arteret që e organizojnë nivelin e pestë.

**Armend Ademi**, tha se asistenti që punësohet për fëmijën e shurdhër duhet të jetë edhe vet i shurdhër për shkak që ia përcjellë ndryshe i shurdhëri të shurdhëritë dhe ndryshe personi që dëgjon një fëmijë të shurdhër, sepse nuk e njeh atë botën tamam prej fillimit kur është shumë fëmijë. Mandej kur bëhet prej klasës të pestë dhe të gjashtë ai e ka pak a shumë të fuqizuar edhe mundet me i përcjellë më shpejtë informatat, interpretuesi ia përcjellë tërë kohën se çfarë po thonë arsimtarët.

Nëse veç dini një rast që një prind ka fëmijë të shurdhër dhe nuk po din ku me e drejtuar fëmijën, ju kisha propozuar me dërguar në Elena Gjike pasi që veçse ka staf që është i dedikuar për persona të shurdhër, për atë po kemi dëshirë të jetë një vend që mblidhen të gjithë aty e mos të jenë të shpërndarë.

Këto trajnimet që propozuat jemi një shoqatë kosovare e të shurdhërve sepse ata i organizojnë kryesisht trajnimet për interpret, asistent në bashkëpunim me ministrinë do të thotë në nivelet qendrore, i kemi pak të ndara kështu lokale dhe qendrore.



**Ramadan Salihu**, tha se në aspekte konkrete dhe ligjore, janë të thirrura shoqatat që bëjnë raste dhe të merren me monitorimin e zgjidhjes së problemeve të tyre. Unë desha të flas për aspektin ligjor që u potencua në fillim, përdorimi i gjuhës së shenjave është i sanksionuar edhe në ligjin para universitar të Republikës së Kosovës dhe në ligjin për Aftësim Profesional dhe Punësim të PAK-ra.

DKA- ja, si punëdhënës i këtyre njerëzve duhet të kërkojë nga Komuna të zgjidhet kjo situatë, se kur do të zgjidhet tani mbetet pjesë e procesit, por ligji e garanton kështu që s'ka nevojë të caktojme që nga fillimi i shfaqjes së nevojës për përdorimin e gjuhës së shenjave, që i bie prej që ia fillon të edukohet ai fëmijë e deri sa t'i duhet gjatë jetës ligji e garanton përdorimin e gjuhës së shenjave.

**Igballe Grajqevci**, i parashtrori pyetje interpretes Besa, pse ka filluar të mësoj gjuhën e shenjave, çfarë iu shtyu ta mësoni.

**Besa Preniqi**, i tha përgjigjen për pyetjen e parashtruar nga parafolësja.

**Armendi Ademi**, dha sqarime, në emër të shoqatës që janë në tërë Kosovën 16 interpret të gjuhës së shenjave të certifikuar të cilët ofrojnë shërbime për personat e shurdhër kudo që kanë nevojë me krye punë në institucionet shtetërore, por deri tani kryesisht janë interpret që kanë në familje persona të shurdhër e që gjuhën e kanë pas të njoftuar e veç janë trajnuar për etikën e punës.

**Igballe Grajqevci**, pyeti Armendin, a e njih ndonjë person që nuk e ka mësuar gjuhën e shenjave prej familjes, prej rrethit, apo prej nevojës që u ka dashtë, por që e ka mësuar prej dëshirës dhe sa kohë iu ka dashur ta mësoj gjuhën e shenjave ai person.

**Armend Ademi**, dha sqarime për pyetjen e parashtruar nga parafolësja.

**Igballe Grajqevci**, tha se është shumë e rëndësishme që çdo njëri me e mësuar sepse besoj që nuk është shumë e vështirë e sidomos mësimdhënësit me i ditë qysh prej fillimit me e ndjekë njëfarë lloj kursi, është shumë e rëndësishme jo vetëm se e ndihmon personin në fjalë por mësimdhënësja është në të njëjtën kohë është edhe reflektuese.

**Ramadan Salihu**, tha se ne flasim gjithnjë për vijën institucionale të çështjeve, mësimi i një shtate në këtë rast gjuhës së shenjave nga OJQ-të është i vlefshëm për nevojat e përditshme, por nuk është ekuivalent me përdorimin zyrtar dhe të kualifikuar të asaj se çka po kërkojmë, mësimi i alfabetit për të verbër e ka burimin në qendrën burimore në Pejë, në shkollën "Xheladin Deda", është institucion shtetëror që i nënshtrohet kriterëve dhe mekanizmave shtetëror ndërsa kur mësohen nga shoqata e të verbërve ai është një mësim i alfabetit Brail për përdorim ditor kujto që i nevojitet por nuk mund të them që është mësim ekuivalent me atë që bëhet në shtet. Andaj i inkurajoj edhe shoqatat dhe të gjithë të tjerët që ta bëjnë një mekanizëm që qendrat burimore në Prizren apo ku i kanë shoqatat të formohet edhe mentaliteti i ngritjes së kuadrove të mësimi të gjuhës zyrtare të shenjave.



**Igballe Grajqevci**, tha se në shkollën ku punojë unë kemi pasur vizitorë nga qendra burimore "Nënë Tereza" në Prizren, që kanë ardhur dhe na ka treguar për punën që kryhet atje dhe nga ai kemi kërkuar që të ofrohet një trajnim që kam qenë gjithmonë e interesuar që disa gjëra elementare me i ditë, për gjuhë të shenjave por sipas atij nuk ofrojnë trajnime dhe kam mbete në kontakt me të, në momentin që ofrojnë trajnime kam qenë e interesime të paktën disa gjëra elementare me i mësuar.

**Armend Ademi**, tha se Shoqata e ka lansu Web faqen në fjalorin e gjuhës së shenjave, janë vidualizu edhe me video, mësuesi i shenjave është kështu që kush që është i interesuar është linku GjShK.org.

**Igballe Grajqevci**, tha se kur kemi mësuar si studente gjithherë temat si p.sh alfabeti i Brailit e këto, ne e kemi pas edhe pedagogjinë speciale, d.m.th vetëm na u kanë dhënë dhe nuk kanë bërë diçka profesorët në universitet që gjatë kohës së studimeve ne me pas një mundësi që me u kyç pak, por në të ardhmen ndoshta do të kish qenë mirë që universiteti i edukimit me marrë më seriozisht që të ketë një lloj provimi që së paku gjërat elementare me i ditë të verbërve, rreth alfabetit të Brailit, jo vetëm alfabeti i Brailit është për të verbër dhe mësimdhënësja nuk din asgjë më tepër, vetëm nëse e ka interesimin ose vullnetin me shkuar me mësuar vetë, por sa mëson më mirë ta mësojë në kuadër të universitetit, që të dijë së paku me u kyçë, sepse ajo atë profesion e ka.

**Armend Ademi**, dha sqarime duke cekur se Shoqata Kosovare e të shurdhërve, veçse qenka në diskutim për këtë që e thatë ju, se si është mundësia që të paktën nëse duhet një zëvendësim ose diçka me bërë, të jetë i aftë të zëvendësoj kolegun, me ditë diçka bazike dhe të thjeshtë.

**Fatime Demolli-Mustafa**, kryesuese i falënderoj të gjithë të pranishmit për pjesëmarrje.

*Mbledhja përfundoi në ora 12:15*

Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami

Kryesuesja e Komitetit  
Fatime Demolli

